



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2460/7 prot.,

Tiranë, më 22.10 2020

**VENDIM**

Nr. 43, datë 22.10 .2020

**PËR**

**MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE QË PËRFITOJNË PËRJASHTIM NGA  
TARIFA E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020, QË STUDIOJNË NË NJË  
PROGRAM STUDIMI TË CIKLIT TË PARË DHE PROGRAM STUDIMI TË  
INTEGRUAR, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË**

Në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenin 51 të statutit të UMT-së, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.40, datë 23.01.2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.269, datë 29.03.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit n-së ë një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” të ndryshuar,” dhe materialin e Administratorit të UMT-së nr.1187/1 prot, datë 16.06.2020 “Propozim për përjashtim nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2019-2020” , Bordi i Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë përjashtimin nga tarifa e studimit, të studentes Megi Arsim Hasa, studente në Fakultetin e Mjekësisë, dega mjekësi e përgjithshme , për vitin akademik 2019-2020. E drejta për tu përjashtuar fillon nga muaji qershor 2020
2. Të miratojë efektin financiar që rrjedh nga ky përjashtim, në vlerën 5,000 (pesë mijë) lekë, vlerë e cila do të pakësojë të ardhurat e UMT-së (Fakultetit të Mjekësisë) për vitin 2020.
3. Të mosmiratojë përjashtimin nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2019-2020, të studentit Zamir Ram Dida, student ne programin master në shëndet publik në Fakultetin e Mjekësisë, të UMT-së .
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë për zbatimin dhe publikimin e tij në faqen zyrtare të UMT-së.

**KRYETARI  
FLORIAN TËTI**

